



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATËVE NGA LISTAT SHUMEMËRORE PËR KËSHILLAT BASHKIAK TË PARTISË DEMOKRACIA SOCIALE, (ASE) NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 19.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listave shumëmemërore për këshillat bashkiak, të partisë Demokracia Sociale në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet për qeverisjen vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 5, pika 4, germa "a" i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,



Nr. 584 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak, të Partisë Demokracia Sociale në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

VËREN

Partia Demokracia Sociale, në përputhje me nenin 5, pika 4, germa "a" të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, të kandidatëve për këshillin e bashkisë, Maliq, Devoll, Peqin, Klos, Ura Vajgurore, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumëmemërore.

Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, të kandidatëve për anëtarë në këshillat bashkiak, për këto bashki : Maliq, Devoll, Peqin, Klos, Ura Vajgurore, asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Zyra e gjendjes gjyqësore me shkresën nr. 3763/1 prot., datë 18.05.2019 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, për bashkitë Maliq, Devoll, Peqin, Klos, Ura Vajgurore sipas së cilës rezultojnë të padënuar nga gjykatat shqiptare përveç shtetasit të mëposhtëm:

Bashkia Maliq, Enver Shkëmbi me nr.7 rendor në bazë të vendimit më nr. 9 datë 16.01.1985 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Vjedhje të pasurisë së tjetrit". Në bazë të nenit 101/l K.p është dënuar me 3(tre) muaj burgim. I rehabilituar në bazë të nenit 69 të K.P.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit, konstaton se për personat e shënuar në listën shumëmemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015. KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Referuar nenit 33, germa "f" të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe pikës 5/1, 6 të nenit 9 të udhëzimit nr. 2, datë 29.01.2013



Nr. 584 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat

Bashkiak, të Partisë Demokracia Sociale në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes

vendore të datës 30 qershor 2019.

“Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve”, KZAZ duhet vazhdojnë procedurat për rregjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e Bashkisë Maliq, Devoll, Peqin, Klos, Ura Vajgurore të Partisë Demokracia Sociale për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstaton se për personat e shënuar në listën shumëmemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015. KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe pikës 5/1, 6 të nenit 9 të udhëzimit nr.2, datë 29.01.2013 "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve", KZAZ-të duhet vazhdojnë procedurat për rregjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e Bashkisë Malësi e Madhe, të Partisë Bashkimi Liberal Demokrat për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019. KZAZ duhet vazhdojnë procedurat për rregjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e Bashkisë, Maliq, Devoll, Peqin, Klos, Ura Vajgurore.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", e ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 5, pika 4, germa "f", të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

VENDOSI:

1. Njoftimin e KZAZ-ve përkatëse për vazhdimin e procedurave për rregjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e Bashkisë , Maliq, Devoll, Peqin, Klos, Ura Vajgurore, Partia Demokracia Sociale për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr . 584 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak , të Partisë Demokracia Sociale në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.